



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:190544

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05798803

C.nr. 2425/17

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve KS “S.U.G.A.” Sh. a., me numër të biznesit 70105804, me seli në Prishtinë, i përfaqësuar me autorizim nga A.A., kundër të paditurit L.N.C. me adresë ish Mati 1 Rr. “N.P.” në Prishtinë, tani me adresë të panjohur, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm Rr.A., avokat nga Prishtina, me objekt të padisë rimbursim i dëmit, në seancën e shqyrtimit kryesor, në prezencën e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqese, ndërsa e përpiloj me datë 10.06.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve KS “S.U.G.A.” Sh. a., me numër të biznesit 70105804, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri L.N.C. me adresë ish Mati 1 Rr. “N.P.” në Prishtinë, tani me adresë të panjohur, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material për aksidentin e datës 29.04.2014 t’ia kompensojë shumën prej 14,261.10 euro (katërbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një euro e dhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit e cila llogaritet nga nxjerrja e këtij aktgjykimi me datë 10.06.2024 e deri në përmbushjen e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit ligjor.

III. OBLIGOHET i padituri L.N.C. me adresë ish Mati 1 Rr. “N.P.” në Prishtinë, tani me adresë të panjohur, që paditëses, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1224.00 euro, në afat prej 15 ditëve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve KS “S.U.G.A.” Sh. a., me numër të biznesit 70105804, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 15.09.2017, kundër të paditurit L.N.C. me adresë ish Mati 1 Rr. “N.P.” në Prishtinë, me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jo material.

Paditësja përmes padisë, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datën 29.04.2014 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit i cili sipas raportit

policor ka ardhur për shkak të vozitësit të mjetit “A” me targa 01-771-GN i siguruar për TPL në S.U.K., i cili nuk i ka respektuar shenjat e trafikut në kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi, ku me këndin e përparmë të majtë të veturës e ka goditur mjetin B Citroen në këndin e majtë përpara i cili në momentin e aksidentit ishte duke u ç’kyqur nga rruga E.M. për të vazhduar në rrugën A.D., ku si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar vozitësi i mjetit B. Ka shtuar se, si pasojë e aksidentit të dëmtuarit A.D., E.D. dhe V.B. kanë paraqitur kërkesë për kompensim dëmi material dhe jo material për shkak të aksidentit në fjalë, dhe të njëjtit janë kompensuar në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore. Tutje ka theksuar se, drejtuesi i automjetit këtu paditësi ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe pa patentë shofer, për çka e ka humbur edhe mbulesën siguroese dhe për këtë paditësja mjetet e paguara nga kjo bazë ka të drejtë t’i regresojë drejtpërdrejt nga shkaktari i automjetit. Nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar ashtu që të detyrohet i padituri L.N.C.me adresë ish Mati 1 Rr. “N.P.” në Prishtinë, tani me adresë të panjohur, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material për aksidentin e datës 29.04.2014 t’ia kompensojë shumën prej 14,261.10 euro (katërmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një euro e dhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit e cila llogaritet nga paraqitja e padisë me datë 15.09.2017 e deri në përmbushjen e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit ligjor.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumën prej 60.00 euro dhe në emër të shumës së deponuar për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm shumën prej 1,164.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 1,224.00 euro.

Me aktvendimin e datës 09.02.2024, sipas propozimit të paditëses gjykata i ka caktuar të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm Rr.A. avokat nga Prishtina, për të vepruar në emër të tij, dhe ketë bazuar në nenin 79 paragraf 3 pika a) të LPK-së, për faktin se nuk është arritur të sigurohet adresa e vendbanimit.

Përmes përgjigjes në padi, në seancat e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke shtuar se në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë – vendim penal me të cilin vërtetohet se i padituri është shpallur fajtor për vepër penale të ngasjes në gjendje të dehur. Ka shtuar se, në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë që vërteton se i njëjti ka qenë i dehur dhe sa promil alkool ka pasur në gjak, dhe prania e alkoolit në gjak nuk është vërtetuar përmes analizave laboratorike ashtu siç duhet të bëhet për të përdorur si provë në procedurë gjyqësore. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar, sepse edhe sikur të kishte prova, kërkesa e paditëses është e parashkruar, pasi që rasti i aksidentit ka ndodhur me datë 29.04.2014, ndërsa padia në gjykatë është ushtruar me datë 15.09.2017, pas tri viteve e pesë muajve, dhe sipas nenit 357 kërkesa për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vite nga data kur i dëmtuari ka marrë në dijeni për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 208.00 euro, për dy seanca gjyqësore secila në shumën prej 270.40 euro, gjithsejtë në shumën prej 748.80 euro.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Kërkesën për rimbursimin e borxhit e datës 13.12.2022 e lëshuar nga paditësja për te paditurin, se bashku me aktgjykimin e gjykatës se Apelit me nr. Ac. 6051/2019 i datës 12.09.2022, transferi bankar i lëshuar nga P.C.B. i datës 16.11.2022 së bashku me urdhër pagesën e datës 15.11.2022, si dhe kalkulimi i demit i shënuar sipas aktgjykimit të Gjykatës se Apelit, Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit rrugor e datës 21.07.2014, Raporti i aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës e datës 29.04.2014, Raporti shtesë me numër të rastit 2014-AR-0920 i lëshuar nga Policia e Kosovës me date 13.06.2014, Kallëzimi penal i lëshuar nga Policia e Kosovës i datës 29.04.2014 i paraqitur kundër të paditurit, Raporti shtesë në lidhje me aksidentin e komunikacionit i lëshuar nga Policia e Kosovës 11.07.2014, Urdhër pagesa e lëshuar nga R.B. e datës 16.01.2015, Marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur mes të paditësit dhe të dëmtuarve e datës 10.12.2014 se bashku me fletëpagesën dhe Marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të paditësit dhe të dëmtuarve e datës 10.09.2014.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas vlerësimit të gjitha provave, gjykata gjeti se me datë 29.04.2014 kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit, për deri sa i padituri L.C. ka qenë duke lëvizur në rrugën “E.M.” në Prishtinë, me veturën Opel Corsa me numër të regjistrimit 01 – 771 GN, me të arritur afër udhëkryqit që lidhet me rrugën “A.D.” nuk ka respektuar shenjën e trafikut, kryqëzimin me rrugë me përparësi kalimi dhe me këndin e përpamë të majtë të veturës e godet veturën citroen, duke shkaktuar dëme materiale dhe jo materiale. I padituri veturën ka qenë duke e vozitur nën ndikimin e alkoolit dhe pa patentë shofer. Këto fakte provohen përmes Raportit të Aksidentit të lëshuar nga Policia e Kosovës me datë 29.04.2014.

Nga Raporti shtesë me numër të rastit 2014-AR-0920 i lëshuar nga Policia e Kosovës me datë 11.07.2014, gjykata konstatoj se natën kur ka ndodhur aksidenti të paditurit nga ana e Policisë së Kosovës nuk i është marr deklarata, sepse pasi që i është bërë alkool testi i njëjti ka rezultuar i dehur. Po ashtu, nga ky raport gjykata konstatoj se të lënduar në momentin e aksidentit kanë qenë drejtuesi i automjetit citroen E.D. dhe pasagjeri i veturës Opel Corsa V.B.

Nga ekspertiza e aksidentit të komunikacionit rrugor e datës 21.07.2014, gjykata konstatoj se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me fajin e të paditurit, i cili duke mos respektuar shenjën e përparësisë së kalimit dhe si pasojë e këtij lëshimi ka shkaktuar aksidentin nga i cili janë shkaktuar lëndime trupore dhe dëme materiale.

Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur mes të paditëses dhe të dëmtuarit V.B. e datës 10.12.2014 gjykata konstatoj se paditësja është pajtuar më të dëmtuarin për pagesën e shumës prej 3.000 euro në emër të kompensimit për dëmin jo material i shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 29.04.2014. Ndërsa, nga Urdhër pagesa e lëshuar nga R.B. e datës 16.01.2015, gjykata konstatoj se me datë 09.01.2015 e njëjta shumë prej 3.000 euro është ekzekutuar.

Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur mes të paditëses dhe të dëmtuarës A.D. e datës 10.09.2014 gjykata konstatoj se paditësja është pajtuar më të dëmtuarën për pagesën e shumës prej 2.671.00 euro në emër të kompensimit për dëmin material i shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 29.04.2014. Ndërsa, nga Urdhër pagesa e lëshuar nga R.B. e datës 16.01.2015, gjykata konstatoj se me datë 19.09.2014 e njëjta shumë prej 2.671.00 euro është ekzekutuar.

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit me numër Ac.nr. 6051/19 gjykata konstatoj se të dëmtuarit nga aksidenti i datës 29.04.2014 E.D., në emër të kompensimit të dëmit jo material është detyruar paditësja në emër të borxhit kryesor të paguaj shumën prej 6234.70 euro, në emër të shpenzimeve shumën prej 624.40 euro, kurse nga urdhërpagesa e datës 15.11.2022 gjykata konstatoj se për shumën e borxhit kryesor paditësja ka paguar edhe kamatën në shumën prej 1731.00 euro, e nga të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 8,590.10 euro, shumë kjo e cila konstatohet së është paguar përmes transferit bankar i lëshuar nga P.C.B. i datës 16.11.2022.

Rtjedhimisht, përmes këtyre provave vërtetohet se paditësja Kompania e Sigurimeve KS "S.U.G.A." Sh. a. si pasojë e aksidentit të ndodhur me datë 29.04.2014 me automjetin që e drejtonte i padituri pa patentë shofer dhe në gjendje të dehur, është detyruar që të dëmtuarve E.D. t'i paguaj shumën prej 8,590.10 euro, A.D. t'i paguaj shumën prej 2.671.00 euro dhe V.B. shumën prej 3.000.00 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 14,261.10 euro.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata konstaton se në këtë çështje juridike kontestuese duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, dhe dispozitat e Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me paragrafin 1 të nenit 136 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se *"Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij."* Në rastin konkret, dëmi është shkaktuar nga i padituri, dhe kjo konstatohet nga ekspertiza e komunikacionit e datës 21.07.2014 dhe Raporti i Aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës me datë 29.04.2014.

Me nenin 14 paragraf 1 nën-paragraf 1.2. dhe 1.3. të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet se: *"1.2. drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimimit; 1.3. mjeti motorik drejtohet nën"*

ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive;” Kurse, me paragrafët 2 dhe 3 të njëjtit nen parashihet se: “2. Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim. 3. Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”

Në rastin konkret, personat e dëmtuar nga aksidenti E.D., A.D. dhe V.B., kanë kërkuar dëmshpërblimin nga paditësja, dhe të njëjtit janë kompensuar për dëmin e shkaktuar nga i padituri, i cili kishte shkaktuar aksidentin duke drejtuar mjetin pa patentë shofer dhe në gjendje të dehur. Sipas dispozitës ligjore të lartcekur, paditësja në rastin konkret, ka të drejtë të kërkojë regres nga i padituri i cili mbahet përgjegjës për shkaktimin e dëmit, në raport me dëmet që i janë kompensuar personave të tretë të dëmtuar.

Gjykata duke u bazuar gjendjen faktike të vërtetuar se me lartë, erdhi në përfundim dhe konstatoj se ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses për rimbursimin e mjeteve, në shumën prej 14,261.10 euro, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 245 paragraf 1 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se: *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç’rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Përmes administrimit të provave, është arritur të vërtetohet gjendja faktike se i padituri në momentin e aksidentit nuk ka pasur patentë shofer dhe ka qenë në gjendje të dehur, andaj mbi bazën e të gjitha provave të administruara në këtë procedurë, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e këtyre provave, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në të njëjtën kohë, gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurit, i cili përmes përgjigjes në padi dhe në seanca gjyqësore ka deklaruar se kërkesëpadia e paditëses është e parashkuar. Lidhur me këtë pretendim, Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 342 paragraf 1, parasheh: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditore të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashkuar diçka tjetër”*, ndërsa në raport me kërkesat për shpërblimin e dëmit në nenin 357 paragraf 1, i njëjti ligj përcakton se: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”* Bazuar në këto dispozita ligjore, e në përputhje me provat materiale të administruara në këtë çështje kontestuese, dhe atë nga Urdhër pagesa e lëshuar nga R.B. e datës 16.01.2015, gjykata konstatoj se me datë 09.01.2015 shuma prej 3.000 euro është ekzekutuar, nga Urdhër pagesa e lëshuar nga R.B. e datës 16.01.2015, gjykata konstatoj se me datë 19.09.2014 shuma prej 2.671.00 euro është ekzekutuar dhe nga transferi bankar i lëshuar

nga P.C.B. i datës 16.11.2022, gjykata konstatoj se kjo shumë është ekzekutuar me datë 16.11.2022. Pas ekzekutimit të mjeteve përmes këtyre urdhërpagesave, gjykata konstatoj se paditësja e ka fituar të drejtën të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga paditësi, dhe kjo e drejtë është kërkuar para kalimit të afatit ligjor prej tri viteve, kjo për faktin se padia në gjykatë është paraqitur me datë 15.09.2017, ndërsa siç u theksua me lartë, pagesat janë ekzekutuar me datë 19.09.2014, me datë 09.01.2015 dhe me datë 16.11.2022.

Kurse, sa i përket pretendimeve të paditurit se nuk i është dhënë mundësia që të vërtetohet përmes analizave të gjakut dhe të urinës nëse i njëjti ka qenë i dehur, e po ashtu nuk ka prova se i padituri nuk kishte patentë shofer me rastin e shkaktimit të aksidentit, gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme. Kjo për faktin se, gjykata nga Raporti i Policisë i datës 29.04.2014 dhe nga Raporti shtesë i Policisë së Kosovës i datës 11.07.2014, konstatoj se i padituri në momentin e aksidentit kishte qenë në gjendje të dehur, e po ashtu nuk kishte patentë shofer, dhe këtë raport gjykata e vlerësoj si të besueshëm, për deri sa i padituri nuk ka ofruar asnjë provë para gjykatës për të argumentuar të kundërtën. I padituri në seancën përgatitore ka propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit V.B. i cili në momentin e aksidentit ka qenë në veturë me të paditurin, i cili do të deklaronte nëse i padituri ka qenë i dehur në momentin kur është shkaktuar aksidenti. Mirëpo, gjykata këtë propozim e ka refuzuar, duke vlerësuar se deklarimi i tillë nuk do të sjellte provë të mjaftueshme për të konstatuar këtë fakt, dhe për të argumentuar të kundërtën e asaj që është konstatuar nga zyrtaret policor nga Policia e Kosovës. Për me shumë, i padituri nuk ka ofruar prova para gjykatës, e po ashtu nuk ka paraqitur propozime për të vërtetuar një gjendje ndryshe nga ajo e konstatuar sikurse me lartë, dhe lidhur me këtë me paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, kurse në lidhshmëri me këtë, me nenin 322 paragraf 2 të LPK-së, është paraparë se: *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”*

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, e cila përcakton se debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, ndërsa lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit. Si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurit për pagesën e kamatës, gjykata ka caktuar datën 10.06.2024, datë kjo kur është nxjerr aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë, shpenzimet i referohen përfaqësimit nga përfaqësuesi i përkohshëm në shumën prej 1,164.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 60.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 1224.00 euro

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:190544
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05798803

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 2425/17, datë 10.06.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.